REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr./Br. 739/20
Datë/Datum. 29.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.739/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: Z. Goran Milenković - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues, Z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.N.SH "Top Projekt "- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "EdiBau-Ing" SH.P.K - Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material ndërtimor për ndërtimin e disa shtëpive të familjeve skamnore në Prizren" me nr. të prok: 622-20-1764-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Prizren" (KK.P), më datën: 28.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: N.N.SH "Top Projekt "- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin prokurimit me titull: "Furnizim me material ndërtimor për ndërtimin e disa shtëpive të familjeve skamnore në Prizren" me nr. të prok: 622-20-1764-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Prizren".

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material ndërtimor për ndërtimin e disa shtëpive të familjeve skamnore në Prizren" me nr. të prok: 622-20-1764-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "KK-Prizren", dhe lënda kthehet në **rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: N.N.SH "Top Projekt "- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues N.N.SH "Top Projekt "- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 01.10.2020 me nr. 739/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "EdiBau-Ing" SH.P.K - Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material ndërtimor për ndërtimin e disa shtëpive të familjeve skamnore në Prizren" me nr. të prok:622-20-1764-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ "KK-Prizren", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 56, 59, 60, 61, 65, 66, 72, si dhe nenin 108/A të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 05.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 13.10.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues N.N.SH "Top Projekt"- Prishtinë

Sqarim hyrës: Komuna e Prizrenit, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës pas ri vlerësimit te ofertave. Kundër të njëjtit njoftim parashtruesi i ankesës ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim tek AK- Komuna e Prizrenit, sipas afateve të parapara me LPP. AK, përmes vendimit ka refuzuar kërkesën si të pa bazuar.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues N.N.SH "Top Projekt" -Prishtinë

Fillimisht eksperti shqyrtues sqaron se kemi të bëjmë me ankesë të përsëritur, ku palët e përfshira në procedurë janë të njëjta, rrjedhimisht disa nga pretendimet ankimore tani veç i kemi trajtuar. Po ashtu, edhe paneli shqyrtues këto pretendime ankimore i ka gjykuar me vendimin e datës 03.09.2020, me nr. 499/20.

Përkatësisht pretendimi ankimor kundrejt kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional, Kërkesa 3. Të ketë së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës. a. Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të ketë minimum 60 % të referencave të natyrës së kontratës. Si dhe 60 % e stafit të kërkuar për këtë projekt

Dëshmia 3. Nën pikën b Lista e të punësuarve, së bashkë me kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt. Eksperti shqyrtues sqaron se Paneli Shqyrtues në vendimin PSH.nr. 499/20 ka konstatuar:

"Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pas analizimit të kërkesës mbi mundësitë teknike dhe profesionale siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe listën e kontratave së bashkuar me kontratat e punës së operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, kjo kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që operatori ekonomik duhet të kenë së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme me listën e të punësuarve së bashkuar me kontratat e punës, ndërsa për stafin e ri kontratat duhet që operatori ekonomik të posedojë kontrata e bashkëpunimit për këtë projekt apo këtë aktivitet të prokurimit. Lidhur me këtë kërkesë të dosjes se tenderit, OE i rekomanduar për kontratë ka bashkangjitur listën e punëtorëve të deklaruar në ATK, ku në këtë listë të vitit 2020 e nxjerr në ATK para dorëzimit të ofertës dhe të vulosur nga ATK, janë të deklaruar vetëm 10 punëtor. Ndërsa, sa i përket pikës tjetër të kësaj kërkese në dosjen e tenderit që ka të bëjë me stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt, Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka të bashkangjitur kontratat për 25 punëtor, ku këto kontrata që të gjitha janë para vitit 2019 dhe asnjëra prej këtyre kontratave nuk ka të bëjë me këtë projekt sikurse është kërkuar në dosje të tenderit që për stafin e ri duhet kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar".

Kurse, në pjesën e fundit të arsyetimit në këtë vendim është cekur:

...Obligohet AK që gjatë rivlerësimit të ofertave të iu përmbahet në tërësi dispozitave të LPP-së, duke u bazuar në kërkesat të cilat i ka përcaktuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë si dhe mos të devijoj nga kërkesat e përcaktuara në dosje e tenderit duke vepruar në kundërshtim me këto kërkesa të cilat vet AK i ka vendosur në dosjen e tenderit...".

Eksperti shqyrtues sqaron se AK përmes procesit të ri vlerësimit ka kërkuar sqarime shtesë përmes letrës standarde për sqarimet e tenderit me datë 16.09.2020, nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me këtë kërkesë për punëtorët e kërkuar përmes FDT-se. OE i ri rekomanduar për kontratë është përgjigjur dhe ka prezantuar listë të re ATK-së, të dt. 16.09.2020, me gjithsej 22 punëtor te përshkruar, për periudhën kohore deri ne muajin Gusht 2020 (para hapjes se ofertave). Ne te njëjtën listë (ATK-se) janë te evidentuar emrat e punëtorëve te përshkruar edhe ne listës se prezantuar ne oferte nga OE edhe tani i rekomanduar për dhënie te kontratës. Po ashtu operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës përmes sqarimeve ka prezantuar edhe kopjet e kontratave ne emër te punëtorëve te prezantuar ne listë me përshkrim se te njëjtit do

te angazhohen ne këtë aktivitet te prokurimit.

Prove bashkangjitur me raport, gjeni kopjen e listës e ATK-së të dt. 16.09.2020, periudha 2020, si dhe kopjen e listës të ATK-së, të dt. 10.04.2020 periudha 2020 dhe listën e punëtorëve.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues që ka të bëjë me pozicionin 1 dhe 2 të paramasës ku OE i rekomanduar për kontratë për pozicionin 1 ka ofruar çmimin tejet të ulët dhe jo serioz në vlerë prej 0.20 euro/metër kub kur dihet se çmim i tregut është së paku 10-15 herë më i lartë. Kurse, për pozicionin 2 OE i rekomanduar ka ofruar çmimin tejet të ulët dhe jo serioz në vlerë prej 0.50 euro/metër kub kur dihet se çmim i tregut është së paku 4 - 6 herë më i lartë.

- Eksperti shqyrtues sqaron se paneli shqyrtues përmes vendim PSH.nr.499/20 ka konstatuar: "... "Rregullat për tenderët Jo-normalisht të ulët" nuk zbatohen për pozicione të caktuara por për tenderët të cilët në shikim të parë duken për autoritetin kontraktues si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat ka gjasa për një përformancë të keqe të kontratës. Po ashtu, kjo rregull gjen zbatim në rastet kur çmimi i ofruar është mbi 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm ose çmimi i ofruar është mbi 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët apo janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tender...". Andaj, eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është "res judicata".

Lidhur me pretendimin e fundit të OE ankues: N.N.SH "Top Projekt" – Prishtinë, se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në dokumentacionin e tenderit ka emëruar inxhinierin Besim Bytyqi si projekt menaxher për këtë projekt duke ofruar kontratë pune e nënshkruar me dt 15.06.2020. Në këtë kontratë nuk specifikohet hyrja në fuqi e kësaj kontrate e as fundi i vlefshmërisë dhe rrjedhimisht kjo kontratë është në kundërshtim me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës dhe si pasojë është e pa vlefshme. Gjithashtu, në dosjes e tenderit është kërkuar që të prezantohen CV-ja e inxhinierit dhe referencat për punët e kryera, ku OE për inxhinierin Besim Bytyqi ka prezantuar referenca për ndërtimin e rrugës dhe asnjë referencë për natyrën e kontratës në fjalë, rrjedhimisht OE është i papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron se tek kërkesa mbi kapacitetit teknik dhe profesional, konkretisht në kërkesën nr. 2, AK ka kërkuar: "Në kuadër të stafit duhet të emërohet me vendim menaxheri për këtë projekt i cili duhet të jetë Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master drejtimi konstruktiv me jo më pak se 5 vite pune në profesion. Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës.

Dëshmia 2. Nën pikën a Diploma e fakultetit kopje, referencat për periudhën e kaluar në profesion së paku për 5 vite, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit me OE për këtë projekt, a. Diploma, CV dhe kontrata e punës ose e bashkëpunimit për këtë projekt"

Lidhur me këtë kërkesë OE i rekomanduar për kontratë ka caktuar me vendim si projekt menaxher

inxhinierin z. Besim Bytyqi, ku i njëjti posedon kualifikimin arsimor sipas kërkesës së FDT-së dhe ka kontratë pune me OE të rekomanduar për kontratë. Sa i përket pikës së kërkesës "të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës", OE i rekomanduar ka bashkangjitur referencat dhe CV e inxhinierit, ku i njëjti ka qenë mbikëqyrës dhe menaxher i projektit në konstruktimin e rrugëve dhe punëve tjera ndërtimore, që për mendimin e ekspertit shqyrtues e plotëson këtë kërkesë të AK-së.

Provë, bashkangjitur gjeni, kopjen e kontratës, Cv, Referencën dhe Vendimin për caktim te menaxherit te projektit, ne emër te z. Besim Bytyçi.

Përfundimisht sipas asaj qe u përshkrua si me larte sqarojmë se AK, kërkesat e aplikuara kundrejt operatoreve ekonomik nuk janë relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse (shiko nenin 51, të LPP-së), konkretisht kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesionale që ndërlidhën me stafin ku është kërkuar "Për stafin e ri kontrata e bashkëpunimit për këtë projekt". Në këtë fazë të aktivitetit të prokurimit, kontrata palët e përfshira në të i fut në marrëdhënie të detyrimeve, rrjedhimisht AK, ka qen dashur ti lejoj ofertuesit qe të oferton me para kontrata, megjithatë kërkesa e njëjte nuk është kontestuar nga ndonjë OE i interesuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Mendimi i ekspertes shqyrtuese:

Bazuar në sqarimet e dhëna në këtë raport propozimi ynë është qe ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, dhe ti lejohet AK-së, të procedoi tutje me aktivitetin e prokurimit, konform dispozitave të LPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 13.10.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë: 13.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datë: 14.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

From: topprojekt nnsh [mailto:topprojekt.pr@gmail.com]
Sent: Ëednesday, October 14, 2020 10:45 AM
To: OSHP
Cc: Blerim Dina; Ardian Behra; Nuhi Paqarizi; Goran Milenkovic; Majlinda Bedrolli
Subject: Kundershtim raport Exsp 739/20

Te nderuar, duke ju njoftuar pranimin e shkresës, ju njoftojmë se NUK PAJTOHEMI me mendimin e ekspertit dhe ne attach gjeni Përgjigjen rreth Kundërshtimit te mendimin e ekspertit nr, 739/20 dt 13.10.2020.

Me respekt
Shaban Krasniqi
Nr. / PRE. 739/20
DT 14.10.2020
Nga : NNSH "Top Projekt"
Për: Organin Shqyrtues te Prokurimit
Lënda: KUNDERSHTIM- Përgjigje rreth mendimit te ekspertit shqyrtues
Te nderuar, ju njoftojmë se NUK PAJTOHEMI me mendimin e ekspertit shqyrtues te datës
13.10.2020 me numër te protokollit 739/20 dhe KERKOJME nga Paneli Shqyrtues i OSHP-se ne seancën përfundimtare te shqyrtoje mosrespektimin e LPP-se nga AK-ja dhe te mos e merr parasysh fare Raportin e ekspertit shqyrtues, si tejet joprofesional dhe te njëanshëm.
Pretendimi 1- Prova Materiale 1.
Operatori ekonomik ka dështuar te plotësoje "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale- Kapaciteti teknik dhe Professional " ku kërkohet:

Kërkesa 3.të ketë së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës.
Dështmia e kërkuar: 3. . Nën pikën b Lista e të punësuarve , së bashku me kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt.
Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontrate, ne dokumentacionin e tenderit ka prezantuar Listën e te punësuarve nda ATK-ja me numër protokolli ATK-PZ nr 62 dt 10.04.2020 ku ne liste janë te evidentuar se Operatori Ekonomik posedon te punësuar një staf prej vetëm 10 persona, rrjedhimisht nuk e plotëson Nenin 9.1 & 9.2 tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe rrjedhimisht është i papërgjegjshëm.

Operatori Ekonomik ka prezantuar një Liste te stafit dhe kontratat e punës për te gjithë punëtoret, gjate analizimit me kujdes te kësaj liste konstatojmë se kjo liste dhe kontratat e ofruara nga Operatori Ekonomik nuk përputhen me Listën e deklaruar ne ATK-se. Shumica e kontratave fiktive te prezantuara janë ne afat te pacaktuar por shumica te nënshkruara ne vitet 2016, 2017, 2018 dhe 2019 me ç'rast Operatori Ekonomik ose ka ofruar kontratë fiktive ose ka mashtruar Autoritetet Tatimore te Kosovës me ç'rast ne te dy rastet ne baze te LPP-se I PAPERGJEGJSHEM.

Ne ankesën e dt 01.10.2020 Bashkangjitur gjeni dokumentacionin për këtë Pretendim NNSH "Top Projekt"

Gjate rivlerësimit AK ne baze te Nenit 72 ka kërkuar sqarimi tek OE EdiBau Ing Sh.p.k. Përmes Letrës Standarde për sqarim te tenderit dt 16.09.2020 ku kërkon Sqarime shtese:

Kërkesa 3. të ketë së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës. Dështmitë e kërkuara: 3. . Nën pikën b Lista e të punësuarve, së bashkë me kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt.

Ne përgjigjen e letrës Standarde OE ka ofruar ne kopje fizike tek AK një Liste te re te ATK-se te dt 16.09.2020 ku ne muajin gusht figuron se OE ka 22 te punësuar dhe ka ofruar kontratë për këtë projekt ne kopje fizike me dt 16.09.2020 –Kontrata qe nuk kanë ekzistuar një pare.

Ne letrën standarde AK-ja ka kërkuar sqarime ne baze te Nenit 72 nga OE dhe ne kundërshtim me LPP-ne ka pranuar dokumente ekzistenca e te cilave nuk mund te vërtetohet se ka qene para hapjes se tenderit, OE ne kundërshtim me Ligjet ne fuqi te Republikës se Kosovës ka dorëzuar dokumente shtese.

Neni 72.

Dokumentacioni dhe informacioni shtesë Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

I kemi bere me dije AK-se ne kërkesën për Rishqyrtim se ne baze te Nenit 72 Pika 3, OE nuk ka pasur te drejte te dorëzojë lista tjera shtese me dt 28.08.2020 (gjoja se është bere me dt 20.07.2020 ditën e dorëzimit) dhe nuk ka pasur te drejte te kërkoje kontrata mbi vepër për këtë projekt dhe te përmbushë 18 punëtor sepse ne një rast tjetër një OE ne te ardhmen mund t'i kërkohet dhe te sjelle 1000 te punësuar, mundet te sjelle Deklaratën nen Betim, mundet te sjelle Sigurimin e tenderit, Vlefshmërinë e tenderit etj.

Eksperti shqyrtues gjate analizimit te lendes QELLIMISHT nuk i ka potencuar faktin se me listën e re te ATK-se dt 16.09.2020 janë shtuar edhe disa punëtorë mirëpo ne kundërshtim me Kërkesën 3 te DT (Kërkesa 3. të ketë së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës. Dëshmitë e kërkuara: 3. . Nën pikën b Lista e të punësuarve , së bashkë me kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt.) janë kërkuar edhe kontratat e punëtorëve me ç'rast me dorëzimin e tenderit janë prezantuar kontrata te skaduara për punëtoret: Luizim Bytyqi kontrata dt 01.02.2016 dhe nuk është lajmëruar ne ATK deri ne Prill/2020 Enver Demiraj kontrata (nënshkruar Ardit Demiraj) dt 07.05.2019 dhe nuk është lajmëruar ne ATK deri ne Prill/2020 NNSH "Top Projck.

Luizim Bytyqi (nënshkruar Lavdim Bugari) kontrata dt 08.07.2017 dhe nuk është lajmëruar ne ATK deri ne Prill/2020 Shpejtim Bytyqi (nënshkruar Qazim Bugari) kontrata dt 01.02.2019 dhe nuk është lajmëruar ne ATK deri ne Prill/2020 Leonard Kastrati kontrata dt 03.06.2018 dhe nuk është lajmëruar ne ATK deri ne Prill/2020 Besim Zogaj kontrata dt 05.05.2018 dhe nuk është lajmëruar ne ATK deri ne Prill/2020 Urim

Spahija kontrata dt 04.05.2017 dhe nuk është lajmëruar ne A TK deri ne Prill/2020 Leonard Kastrati kontrata dt 03.06.2018 dhe nuk është lajmëruar ne A TK deri ne Prill/2020 Asllan Sellaj (nënshkruar Afrim Gega) kontrata dt 06.04.2018 dhe nuk është lajmëruar ne ATK deri ne Prill/2020 Avni Musaj kontrata dt 05.06.2019 dhe nuk është lajmëruar ne ATK deri ne Prill/2020 Shqipron Bytyqi kontrata dt 01.04.2016 dhe nuk është lajmëruar ne ATK deri ne Prill/2020 Fadil Musaj kontrata dt 05.06.2019 dhe nuk është lajmëruar ne ATK deri ne Prill/2020

Ne baze te Legjislacionit ne fuqi dhe Ligjit te punës nëse një kontrate është ndërprerë duhet te palët te bëjnë kontrate te re, pra një mosdeklarimin e pagave ne ATK ne baze te kontratave te lartcekura ato janë ndërprerë dhe është dashur te prezantohen kontratat e reja, pra OE është i Papërgjegjshëm sepse nuk ka dorëzuar kontratat me punëtoret e lartcekur dhe ka mashtruar duke mos i paguar tatimet për kontratat e deklaruara.

Gjate analizimit te listës se Punëtorëve te ofruar ne kundërshtim me Dispozitat e LPP-se, KONSTATOJME :

-Kontrata te punëtorëve te rregullta siç kërkohet ne DT janë 10 cope

-Kontrata te punëtorëve te skaduara 11 cope.

-Kontrata te punëtorëve te skaduara dhe te plotësuara me kontrate ne kundërshtim me LPP-ne mbi vepër janë 14 cope, rrjedhimisht OE është i I PAPERGJEGJSHEM, Ne ankesën e dt 01.10.2020 Bashkangjitur gjeni dokumentacionin për këtë Pretendim Pretendimi 4 Pretendimi 4- Prova Materiale 4.Operatori Ekonomik i propozuar për shpërblim me kontrate ne dokumentacionin e tenderit ka emëruar Inxhinierin Besim Bytyqi si projekt menaxher për këtë projekt, duke ofruar kontrate pune e nënshkruar me dt 15.06.2020. Ne këtë kontrate nuk specifikohet hyrja ne fuqi e kësaj kontrate e as afati i vlefshmërisë dhe rrjedhimisht kjo kontrate është ne kundërshtim me Ligjet ne fuqi ne Republikën e Kosovës dhe si pasoje është e PA vlefshme, rrjedhimisht OE është i PAPERGJEGJSHEM. Gjithashtu ne DT është kërkuar qe te prezantohet CV-ja e inxhinierit dhe referencat për punët e kryera ku për Inxhinierin Besim Bytyqi OE ka prezantuar referenca për Ndërtimin e Rrugëve dhe asnjë reference për natyrën e kontratës ne fjale, rrjedhimisht OE është i PAPERGJEGJSHEM. Eksperti shqyrtues dhe ne këtë pike gjate analizimit te lendes QELLIMISHT nuk i ka potencuar faktin se Kontratat e nënshkruar me Inxhinierin e ndërtimit njëherit edhe projekt menaxher Besim Bytyqi nuk është ne rregull dhe siç kemi pretenduar ne ankese nuk provon efekt juridik dhe rrjedhimisht OE është i papërgjegjshëm, sepse po te ishte kontrata ne rregull inxhinieri ne fjale tashme do te ishte ne Listën e ATK-se te dt 16.09.2020 dhe do te ishte paguar ne baze te kontratës, rrjedhimisht OE është i PAPERGJEGJSHEM.

Pika tjetër lidhet me referencat e inxhinierit, Eksperti shqyrtues pranon se ne CV dhe Referencat e prezantuar për këtë inxhinier janë konstruktimin e rrugëve por QELLIMISHT dhe ne mënyrë joprofesionale thotë janë te natyrës se kontratës gjë qe nuk qëndron sepse natyra e kontratës kërkon referenca te ndërtimit te larte ndërsa rrugët bëjnë pjese te ndërtimi i ulet. rrjedhimisht OE është i PAPERGJEGJSHEM. Ne ankesën e dt

01.10.2020 Bashkangjitur gjeni dokumentacionin për këtë Pretendim

Një fakt tjetër qe Eksperti shqyrtues gjate analizimit te lendes QELUMISHT nuk e ka analizuar fare është se Një Ofertues, respektivisht Konzorciumi Alfa Ing NPN & Korabi shpk & Renelual Tahiri NTP, janë TERHEQUR nga aktiviteti i prokurimit dhe ne kete rast Autoriteti i Kontraktues gjate Rivlerësimit i ka trajtuar si te Përgjegjshëm ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se.

Përfundim: Kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i Prokurimit te mos e merr për baze Raportin e Ekspertit shqyrtues te bëni Anulimin e Njoftimit mbi Vendimin e AK te datës 21.09.2020 dhe te Urdhërohet AK- qe gjate rivlerësimit Operatoret Ekonomik qe janë tërhequr nga Aktiviteti i Prokurimit te trajtohen si Pale pa Interes dhe te mos vlerësohen, dhe Ne te shpallemi fitues me çmimin me te ulet nga operatoret e përgjegjshëm për tenderin në fjalë.

Me Respekt

Shaban Krasniqi

NNSH "Top Projekt"

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 28.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.N.SH "Top Projekt" –Prishtinë, ku pretendimi ankimor ka të bëjë kundrejt kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional, Kërkesa 3. Të ketë së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës. a. Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të ketë minimum 60 % të referencave të natyrës së kontratës. Si dhe 60 % e stafit të kërkuar për këtë projekt; Dëshmia 3. Nën pikën b Lista e të punësuarve, së bashkë me kontratat e punës, për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt.

Paneli Shqyrtues sqaron se në vendimin PSH.nr. 499/20 është konstatuar:

> "*...Lidhur me këtë kërkesë të dosjes se tenderit, OE i rekomanduar për kontratë ka bashkangjitur listën e punëtorëve të deklaruar në ATK, ku në këtë listë të vitit 2020 e nxjerr në ATK para dorëzimit të ofertës dhe të vulosur nga ATK, janë të deklaruar vetëm 10 punëtor. Ndërsa, sa i përket pikës tjetër*

të kësaj kërkese në dosjen e tenderit që ka të bëjë me stafin e ri kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt, Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka të bashkangjitur kontratat për 25 punëtor, ku këto kontrata që të gjitha janë para vitit 2019 dhe asnjëra prej këtyre kontratave nuk ka të bëjë me këtë projekt sikurse është kërkuar në dosje të tenderit që për stafin e ri duhet kontratat e bashkëpunimit për këtë projekt. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar".

Kurse, në pjesën e fundit të arsyetimit në këtë vendim është cekur:

"*...Obligohet AK që gjatë rivlerësimit të ofertave të iu përmbahet në tërësi dispozitave të LPP-së, duke u bazuar në kërkesat të cilat i ka përcaktuar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë si dhe mos të devijoj nga kërkesat e përcaktuara në dosje e tenderit duke vepruar në kundërshtim me këto kërkesa të cilat vet AK i ka vendosur në dosjen e tenderit...*".

Pra, në vendimin paraprak ishte konstatuar që kontratat e prezantuara ishin para vitit 2019 dhe nuk ishin për këtë projekt sikurse është kërkuar në FDT. Kurse, AK gjatë ri vlerësimit kishte kërkuar sqarime shtesë me datë 16.09.2020 përmes letrës standarde për sqarimet e tenderit nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me këtë kërkesë për punëtorët e kërkuar përmes FDT-së. OE i ri rekomanduar për kontratë është përgjigjur dhe ka prezantuar listë të re ATK-së, të dt. 16.09.2020, me gjithsej 22 punëtor të përshkruar për periudhën kohore deri në muajin Gusht 2020 (para hapjes së ofertave). Në të njëjtën listë (ATK-së) janë të evidentuar emrat e punëtorëve të përshkruar edhe në listën e prezantuar në ofertë nga OE edhe tani i rekomanduar për dhënie te kontratës. Po ashtu operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës përmes sqarimeve ka prezantuar edhe kopjet e kontratave në emër të punëtorëve të prezantuar në listë me përshkrim se të njëjtit do të angazhohen në këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë, Paneli Shqyrtues duhet të sigurohet nëse ekzistenca e këtyre kontratave ka qenë para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe nëse këto kontrata mund të verifikohen në mënyrë objektive, si dhe a janë prezantuar këto kontrata 72 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues që ka të bëjë me pozicionin 1 dhe 2 të paramasës ku OE i rekomanduar për kontratë për pozicionin 1 ka ofruar çmimin tejet të ulët dhe jo serioz në vlerë prej 0.20 euro/metër kub kur dihet se çmim i tregut është së paku 10-15 herë më i lartë. Kurse, për pozicionin 2 OE i rekomanduar ka ofruar çmimin tejet të ulët dhe jo serioz në vlerë prej 0.50 euro/metër kub kur dihet se çmim i tregut është së paku 4 - 6 herë më i lartë.

Paneli Shqyrtues sqaron se në vendimin PSH.nr.499/20 është konstatuar: "..."Rregullat për tenderët Jo-normalisht të ulët" nuk zbatohen për pozicione të caktuara por për tenderët të cilët në shikim të parë duken për autoritetin kontraktues si jo të besueshëm nëse krahasohet me objektin e kontratës dhe në përputhje me rrethanat ka gjasa për një përformancë të keqe të kontratës. Po ashtu, kjo rregull gjen zbatim në rastet kur çmimi i ofruar është mbi 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm ose çmimi i ofruar

është mbi 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët apo janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tender...". Andaj, Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim është "res judicata".

Lidhur me pretendimin e fundit të OE ankues: N.N.SH "Top Projekt" – Prishtinë, se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në dokumentacionin e tenderit ka emëruar inxhinierin Besim Bytyqi si projekt menaxher për këtë projekt duke ofruar kontratë pune e nënshkruar me dt 15.06.2020. Në këtë kontratë nuk specifikohet hyrja në fuqi e kësaj kontrate e as fundi i vlefshmërisë dhe rrjedhimisht kjo kontratë është në kundërshtim me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës dhe si pasojë është e pa vlefshme. Gjithashtu, në dosjes e tenderit është kërkuar që të prezantohen CV-ja e inxhinierit dhe referencat për punët e kryera, ku OE për inxhinierin Besim Bytyqi ka prezantuar referenca për ndërtimin e rrugës dhe asnjë referencë për natyrën e kontratës në fjalë, rrjedhimisht OE është i papërgjegjshëm.
Paneli Shqyrtues sqaron se tek kërkesa mbi kapacitetit teknik dhe profesional, konkretisht në kërkesën nr. 2, AK ka kërkuar: "Në kuadër të stafit duhet të emërohet me vendim menaxheri për këtë projekt i cili duhet të jetë Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose master drejtimi konstruktiv me jo më pak se 5 vite pune në profesion. Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës.
Dëshmia 2. Nën pikën a Diploma e fakultetit kopje, referencat për periudhën e kaluar në profesion së paku për 5 vite, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit me OE për këtë projekt, a. Diploma, CV dhe kontrata e punës ose e bashkëpunimit për këtë projekt"
Paneli Shqyrtues sqaron se lidhur me këtë kërkesë OE i rekomanduar për kontratë ka caktuar me vendim si projekt menaxher inxhinierin z. Besim Bytyqi, ku i njëjti posedon kualifikimin arsimor sipas kërkesës së FDT-së dhe ka kontratë pune me OE të rekomanduar për kontratë. Sa i përket pikës së kërkesës "të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës", OE i rekomanduar ka bashkangjitur referencat dhe CV e inxhinierit, ku i njëjti ka qenë mbikëqyrës dhe menaxher i projektit në konstruktimin e rrugëve dhe punëve tjera ndërtimore, por AK gjate rivlerësimit te vërtetoj këtë pretendim ankimor te OE ankues se a e plotëson kërkesën e AK-se inxhinieri ne fjalë.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore, vjen në përfundim se AK me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve nuk e ka sqaruar çështjen e kontratave të OE të rekomanduar për kontratë nëse ekzistenca e këtyre kontratave ka qenë para datës së skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe se te sigurohet AK se janë dorëzuar dokumentet konform nenit 72 te LPP-se.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KK-Prizren" (KK.P),

1x1 OE N.N.SH "Top Projekt" - Prishtinë,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.